


# NË DEMOKRACI



# KA BARAZI

## KUVENDIMET E DEPUTETËVE

OLT (10), FLUTURË (10), ERION (10), BLINERA (10), RIJAD (10), JEHONA (10), ARDONIT (10), ALESA (10)



**Nuk ka rëndësi se cilit komunitet i takojnë deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, e rëndësishme është që ata t'i kryejnë përgjegjësitë e tyre si përfaqësues të popullit**

### **Kuvendi është institucioni më demokratik në Kosovë. Prandaj, ne e duam dhe e respektojmë atë**

Lexues të rregullt të gazetës „Demos-ti“, sot në artikullin e përgatitur nga ne, mund të lexoni për disa gjëra shumë të rëndësishme. Cilat janë ato do t'i kuptoni në vazhdim. Fjala është për formën e qeverisjes më të avancuar të kohës, e cila quhet demokraci.

Demokracia është mënyrë e të jetuarit dhe të punuarit së bashku, duke u bazuar në liri, barazi, drejtësi, si dhe respekt reciprok.

Në demokraci, pavarësisht rrethanave, kush jemi ne, çfarë prejardhje kemi, apo çfarëdo qoftë tjetër, ne e kemi të drejtën të na dëgjohet zëri, si dhe të drejtën të përfaqësohemi denjësisht nga përfaqësuesit tanë. Ne

po ashtu, kemi edhe shumë të drejta të tjera.

Në Kosovë, kompetencën e përfaqësimit tanë e kanë 120 deputetë. Kjo kompetencë vie si rrjedhojë e procesit zgjedhor. Pra, ne si qytetarë i zgjedhim këta përfaqësues, me anë të votës.

Deputetët punojnë në institucionin e quajtur Kuvend. Në sallën e Kuvendit, zakonisht çdo të enjte, deputetët mblidhen dhe diskutojnë çështje shumë serioze, të cilat lidhen me jetën tonë. Kuvendi i Kosovës i ka disa detyra, të cilat ndryshe i quajmë funksione. Njëri nga ta është funksioni përfaqësues, i cili ka për qëllim përfaqësimin e popullit; gjithashtu është funksioni legjislativ, funksion i cili ka të bëjë me miratimin apo mos miratimin e ligjeve; si dhe funksioni kontrollues, ku kontrollonhet puna e Qeverisë.



**Alesa dhe Flutura duke e shkruajtur artikullin**



**Gazetarët duke i kryer punët e tyre**

**Në këtë pjesë të artikullit do t'i paraqesim disa shembuj se si ndikon demokracia dhe Kuvendi i Kosovës në jetën tonë. Shpresojmë që edhe ju, të dashur lexues, do ta gjeni veten tek këta shembuj**

Kemi raste të ndryshme ku Kuvendi i Kosovës e që ndryshe e quajmë „Shtëpia e Popullit“, lidhet me përditshmërinë tonë. Disa nga këto raste i kemi shkruar më poshtë.

Ligji për vijimin e mësimave që nga shkollimi parafil-lorë e deri tek ai i mesëm i ulët është i obligueshëm për të gjithë qytetarët. Ky ligj është miratuar pikërisht nga deputetët, të cilët punojnë në Kuvend. Qëllimi i këtij ligji është që në shtetin tonë të mos ketë qytetarë analfabet. Prandaj, meqë ne jetojmë në demokraci, të

të drejtë të marrim pjesë në procesin zgjedhor. Përmes pjesëmarrjes sonë në zgjedhje, përveçse i zgjedhim përfaqësuesit tanë, ne gjithashtu kontribuojmë në ndërtimin e shtetit të Kosovës. Këto veprime na bëjnë neve qytetarë aktiv.

Sot jemi bindur edhe më shumë se demokracia na i plotëson kërkesat tona si qytetarë me elementet e saj. Respektimi i këtyre elementeve tregon se ne jemi qytetarë të civilizuar e evropian.

Ne sot e respektuam njëri-tjetrin, u solidarizuam me



**Duart e arta të Ardoniut duke vizatuar**



**Gazetarë me vlera demokratike**

gjithë neve, pa asnjë dallim, na ofrohet e drejta e sh-frytëzimit të kësaj mundësie.


Një ligj tjetër i miratuar në Kuvend thotë se të gjithë ne si qytetarë, kur të arrijmë moshën 18 vjeçare kemi

njëri-tjetrin, bashkëpunuam me njëri-tjetrin dhe u nd-jemë të barabartë e pa asnjë dallim. Këto sjellje do të vazhdojmë t'i praktikojmë edhe në përditshmërinë tonë, kudo që shkojmë.



# TË GJITHË E KEMI TË DREJTËN PËR TË VOTUAR

TRINGË (9), VERONA (10), DIONA (10), VIOLA (10), ART (10), ENDRIT (9), ANTIK (10)



## Zgjedhjet lokale në Kosovë po afrohen dhe të gjithë qytetarët janë të lumtur që do ta kenë mundësinë të votojnë për komunën e tyre

Zgjedhjet janë zemra e demokracisë. Me anë të tyre, populli shpreh mendimin e vet lirshëm. Këtë e mundëson demokracia, e cila është gurthemeli i një shoqërie të shëndoshë dhe të arsimuar.

Të zgjedhësh, do të thotë të mendosh për të mirën e vendit tënd. Kështu janë duke vepruar edhe prindërit



Demokracia po rritet nga populli i mrekullueshëm

e mi, të cilët që një kohë të gjatë janë duke menduar se kë ta votojnë për Kryetar Komune dhe për Asamble Komunale. Ata janë shumë të preokupuar me të ardhmen e Komunës sonë, sepse duan që ajo të udhëhiqet nga njerëzit më të mirë. Si rrjedhojë, nëse ata e bëjnë zgjedhjen e duhur, komuna jonë do të zhvillohet edhe më shumë. Prandaj, çdo ditë prindërit e mi po e ndjekin fushatën zgjedhore në mënyrë që të informohen

se çfarë planprograme kanë përgatitur kandidatët për kryetarë komune. Ky fakt po më përgatit edhe mua që do të jem votues i së ardhmes. Me anë të debateve që po zhvillohen në shtëpinë time, unë po mësoj më shumë për procesin zgjedhor dhe rëndësinë e të jetuarit në një shtet demokratik. Po ashtu, e kam kuptuar shumë mirë se nëse të gjithë qytetarët i japin rëndësi të veçantë këtij procesi, e ardhmja e popullit do të jetë edhe më e ndritur.

Unë kam marrë mësim nga prindërit edhe kur kanë qenë zgjedhjet qendrore. Gjithsesi se edhe gjatë atyre zgjedhjeve është menduar mirë nga ana e tyre se kush duhet ta udhëheq vendin. Kështu, kam kuptuar se prindërit ishin të kënaqur me përzgjedhjen e bërë. Prandaj, qytetarë të dashur ju po e shihni se sa i rëndësishëm është procesi zgjedhor dhe vota juaja. Ju e keni fuqinë në duart tuaja. Prandaj, duhet të votoni, sepse e keni përgjegjësi ndërtimin e shtetit demokratik.



Votuesit e së ardhmes

# QYTETARË TË LIRË, AKTIV DHE HUMAN

ENDRINA (10), VLERA (10), ARDITA (9), ZGJIM (10), DORART (10), ULIKS (10), BLINERA (9),

LORENA (10)

**Mirësevini në artikullin tonë „Qytetaria Aktive„. Në këtë artikull, ju lexues të dashur, do të lexoni disa informata për këtë temë. Neve na pëlqeu shumë kjo temë dhe shpresojmë që edhe juve do t'iu pëlqejë po aq sa edhe neve**

Përshëndetje të gjithëve! Ne do t'iu njoftojmë me një person shumë të mirë. Ajo është mami im, e cila ka emrin Humane. Ajo është qytetare e Kosovës dhe ka një jetë shumë të lumtur në Kosovë. Si ajo, në Kosovë jetojnë të lumtur edhe pjesëtarët e etnive të ndryshme, si: serbët, ashkalinjtë, egjiptianët, turqit, romët, goranët dhe boshnjakët. Edhe pse të ndryshëm, të gjithë janë të regjistruar në regjistrin civil kosovar. Kjo është ajo që i bën ata qytetarë të Kosovës.

Personazhi ynë Humana ka mbi 18 vjet dhe mund të votojë në zgjedhjet e shtetit tonë. Por, si voton ajo? Ajo voton në një letër ku janë të shkruar të gjithë kandidatët. Në të e bën një shenjë tek kandidati, për të cilin ajo mendon se është më i miri për të dhe për

qytetarët e tjerë. Po ashtu, Humana mund të nënshkruajë peticione, të protestojë dhe të ankohet në Komunën e saj.

Me këto veprime, ajo është një qytetare aktive. Por, gjithashtu ajo me emrin e saj është edhe humane. Ajo ndihmon të varfërit, pastron mjedisin, mbjell lule dhe pemë të gjelbërta dhe bën punë vullnetare për Kryqin e Kuq të Kosovës.


Edhe ne së bashku si klasë, kemi ndihmuar një vajzë e cila quhet Bleona. Ajo kishte lënduar këmbën në një aksident rrugor dhe klasa jonë mbledhi e dhuroi të holla për ta ndihmuar atë. Ne të gjithë jemi treguar qytetarë human dhe në fund, me ndihmën tonë, ajo u shërua.



Këshillë për të gjithë juve, qytetarë të dashur



Këta jemi ne, gazetarët e vegjël



Humana dhe shoqet e saj po ndihmojnë të varfërit



Qytetarët aktiv votojnë rregullisht



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:  
Tel: +381 38 704 560  
E-mail: [info@demos-ti.org](mailto:info@demos-ti.org)  
Website: [www.demos-ti.org](http://www.demos-ti.org)

Pjesëmarrësit:  
SHFMU „Halil Alidema“  
Klasa: V-3  
Vendi: Pozheran, Viti